

RAPORTI I SHQYRTIMIT PUBLIK

PZHK (2020-2028)

Bazuar në ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor nën 20 dhe udhëzimit administrativ të MMPH 05/2014, Komuna e Gjilanit respektivisht Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, publikon Raportin e Shqyrtimit Publik të Planit Zhvillimor Komunal të Gjilanit për periudhën 2020- 2028.

Draft Plani Zhvillimor Komunal ka qenë në diskutim publik nga data 01.08.2020 e deri më datë 01.09.2020.

Pjesa grafike dhe pjesa tekstuale e prioriteteve, kanë qenë të ekspozuara në hollin e Drejtorisë për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në adresën elektronike **”dupmm.gjilan”** e cila ka qenë dhe është në dispozicion për të interesuarit ku përmes rrjeteve sociale japin vërejtjet , sugjerimet dhe komentet e që në fakt për periudhën kohore prej tridhjetë (30) ditësh për këtë draft dokument nuk ka pasë.

Brenda periudhës kohore të Shqyrtimit Publik, me masa të kufizuara dhe mbrojtëse (për shkak të pandemisë) më datë 25.08.2020 përmes Klubit të Gazetarëve **“Beqir Musliu”** është mbajtur debat me qytetarë dhe Shoqëritë Civile në Gjilan me temën **“ Masterplani në syrin e shoqërisë civile”** i cili i`u është referuar Planit Zhvillimor Komunal në periudhën 2020-2028 .Në debat janë ftuar ekspertët në fushat e ndryshme , shoqëritë civile, përfaqësuesit e bizneseve dhe mediat lokale. Debatin ka pasur për qëllim të shoh përparësitë , të metat,shqetësimet dhe kërkesat eventuale lidhur me draft dokumentin e Planit Zhvillimor Komunal.

Gjatë periudhës kohore të diskutimit publik për dokumentin në fjalë, nga qytetarët të cilët kanë vizituar dhe shikuar dokumentin, në librin e ekspozuar në holl kanë lënë vërejtjet me shkrim. Vërejtjet kryesisht kanë qenë në zonat në të cilat kanë qenë parcelat kadastrale të tyre.

Raporti I Shqyrtimit Publik për Planin Zhvillimor Komunal

Autoriteti përgjegjës i Planifikimit Hapësinor sipas Ekipit Bazë (EB) dhe Ekipës Komunale të Planifikimit (EKP) kanë shqyrtuar e analizuar dhe i`u është përgjigjur secilës kërkesë në formë të shkruar .

Ne faleminderojmë të gjithë qytetarët , MEA , Shoqëritë Civile,mediat elektronike dhe lokale , për vërejtjet dhe ndihmen e tyre në pasurimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhen minimum tetë (8) vjeqare 2020-2028.

Emri e mbiemri	Data	Naporti I Shqyrtimit telefonit	Ankesa shqyrtues për Planin Zhvillimor Komunal	Arsyetimi
Fadil Sherifi	13.08.2020		<i>“ Bazuar në kërkesat e qytetarëve për ndryshimet në infrastrukturen rrugore dhe gjendjes ekzistuese veç se të ndërtuar, ku në kuader të Planeve Rregulluese Urbane të cilët datojnë që nga viti 2010 e të cilët ende janë në fuqi , në disa blloqe urbane ka qenë dhe është e pamundur të realizohen profilet rrugore të planifikuara të rrugëve lokale , rrugëve për qasje e në disa raste edhe rrugët përmbledhëse. Të natyrës së njejtë kemi edhe lokacionet e caktuara të institucioneve publike (arsimore , shëndetësore, etj....). Prandaj propozoj që nivelet e rrugëve të lartëcekura të trajtohen në Harten Zonale të Komunës e jo në PZHK. Sa i përket lokacioneve për institucionet publike të përshkruhen si dispozita me të cilat do të trajtohen dhe përcaktohen lokacionet në nivele më të ulta të dokumenteve konkretisht në HZK dhe PRrH ”</i>	Pas shqyrtimit dhe analizës së propozimit, vendoset që infrastruktura rrugore dhe teknike e cila është e planifikuar në Planet Rregulluese Urbane, disa nga rrugët përmbledhëse, lokale dhe për qasje trajtohen në Harten Zonale të Komunës apo në Planet Rregulluese të Hollësishme . Sa I përket hapësirave të planifikuara për institucione publike në lokacionet e ndryshme sipas Planeve Rregulluese Urbane, kryesisht do të mbesin të njejtat e më pastaj për kushte zhvillimore dhe kriteret e ndertimit në kuadër të zonave për shërbime të trajtohen në Hartën Zonale të Komunës apo Planet Rregulluese të Hollësishme nëse parashihen .

Raporti I Shqyrtimit Publik për Planin Zhvillimor Komunal

“ARKATANA“ Sh.p.k 9 07/6850	13.08.2020	045/696-525	<i>“Ankesa , kundërshtimi, komentet dhe sugjerimet Gjilan lidhur me parcelen kadastrale (nuk është specifikuar numri i parcelës kadastrale por lokacioni i Shtëpisë së mallërave në qendër) Kundërshtim lidhur me trajtimin e parcelës si park dhe objektit tonë bibliotekë “</i>	Në parcelën kadastrale P-70403013-3781-1 ndërtimi ekzistues“ Shtëpia e mallërave” është e planifikuar me destinim afarizëm.
Iniciativë Qytetare	19.08.2020	044/704-031	<i>“ Shumica e banorëve të kësaj ane të banimit për rreth Lumit Mirusha kanë kërkesë për lejimin e ndërtimit të lartë. Dëshira e kësaj kërkesë është për të bërë ndryshimin dhe modernizimin e kësaj zone me investime të reja në ndërtimin e lartë I cili do të mundësonte një pamje më të bukur kësaj pjesetë qytetit dhe do të mundësonte zhvillimin e bizneseve individuale në të mirë të kësaj zone”</i>	Analizuar destinimet sipas Planit Rregullues Urban “ Qesmja e Petigovcit “, ndërtimin e banimit individual kompakt të Lagjes Dardania (Planifikimi i viteve të 80-ta dhe ekzekutuar sipas standardeve urbane) dhe hapësirave të konsumuara për rreth me banim individual dhe infrastrukturë të rregullar , kërkesa e juaj për ndryshim nga banimi individual veç se të ndërtuar në banim kolektiv nuk aprovohet .
Musa Gërbeshi	24.08.2020		<i>“ Unë pronari i parcelës numër 420/3, 423-3 jemë i paknaqur me dstitimin dhe kerkoj të ndrohet destinimi dhe tjet harmoni me kerkesat e mia dhe destinimi te jet object afarist banesor . Kerkesen ton</i>	Lokacioni i planifikuar për Institucion parashkollor sipas Planit Rregullues Urban” Gllama“ ku përfshihen edhe parcelat me nr 70403013-420-3 dhe 421-3 do të jetë

Raporti I Shqyrtimit Publik për Planin Zhvillimor Komunal

			<i>e kemi të adresume në drejtori dhe me par dhe presume nga drejtorja që kekesa jem të mirret në konsiderat”</i>	Zonë e Shërbimeve, në të cilën do të trajtohet hapësira për institucione publike .(Parcela kadastrale 423/3 në Zonën kadastrale të Gjilanit nuk ekziston!)
Musa Gerbeshi	27.08.2020	044/477-377	<i>“ Unë Musa Gerbeshi nga Gjilani kun ë pronat tona që posedojm ne vendin Gllama , me numër të parceles 420-3 dhe 421-3 kemi kërku leje për ndërtim dhe nuk na lejohet sipas planit urbanistic që njkoh të gjat që esht si destinacion ci vend për qerdhe . Ku na nuk jemi të pëlqimit për ket plan. Ne I drejtohem Drejtoris Urbanistike që ta ndron destinimin në parcelat tona të cekura më lart,kun a kerkojm të ndrrohet plani që neve tna lejohet e drejta për banim dhe afarizëm. Ne më datë 25.09.2019 , kemi be një ankes kur deri më sod skemi një përgjigje nga urbanizimi që ta kem të drejten për ndërtim. Andaj kërkojm ta ken konsiderat kerkesen tonë “</i>	Lokacioni i planifikuar për Institucion parashkollor sipas Planit Rregullues Urban” Gllama“ ku përfshihen edhe parcelat me nr 70403013-420-3 dhe 421-3 do të jetë Zonë e Shërbimeve, në të cilën do të trajtohet hapësira për institucione publike

Raporti I Shqyrtimit Publik për Planin Zhvillimor Komunal

Muhamet Morina	28.08.2020	048/503 - 773	<i>“ Unë pronar I parcelës me numër 00420-2 dhe 00421-2 jemi të pakënaqur me destinimin dhe kërkojm të ndrohet destinimi dhe të jet në harmoni me kerkesat e mija. Destinimi të jet object afarist banesor . Ju lutem ket kerkes të shqyrtohet me konsiderat. Kjo kerkes esht asht ba edhe me pëlqimin e fqinji ton Musa gerbeshi me numer parcele 0421-3 dhe 0420-3 ”</i>	Lokacioni i planifikuar për Institucion parashkollor sipas Planit Rregullues Urban” Gllama“ ku përfshihen edhe parcelat me nr 70403013-420-2 dhe 70403013-421-2 do të jetë Zonë e Shërbimeve, në të cilën do të trajtohet hapësira për institucione publike
Milazim Halimi	31.08.2020	044/0396-343	<i>“ E parashtroj ket ankes per arsye se ne baz te skices te cilen e keni ba do te damtohem ne pronen time te cilen e trashigoj nga prindet e mi dhe e shfrytzoj për mbajtjen e familjes time. Fjala asht per parcelen kadastrale N-P.70403020/00541/2 e cila ndodhet në fshatin e Luivoqi Ulet gjegjesisht ne rrugen regjionale Gjilan/ Ferizaj te rrethi ne fshatin Livoq. Pranda kerkoj qe skicen te cilen e keni plansfiku per nji rrug tjeter e ne te cilen nuk ju keni përmbajt projektit te mbershem per shkaqe qe ju e dini dhe interesa te dikujt po e shfrytzoni pronen time ku</i>	Infrastruktura rrugore e planifikuar në mes të dy Planeve Rregullues Urbane “ Kodra e Thatë ” dhe “ Qarku 1” është e harmonizuar dhe e ekzekutuar. Infrastruktura rrugore “ Qarkorja e jashtme” është përcaktuar nga Komuna e Gjlanit dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës .

Raporti I Shqyrtimit Publik për Planin Zhvillimor Komunal

			<i>katégorikisht e refuzoj dhe do ta mbroj me të gjitha mjetet ”</i>	
Menderez Kadriu	01.09.2020	044/ 212 - 000	<i>“ Qytetarët e rrugës “Ramadan Salihu” Gjilan kerkojn nga Drejtoria Urbanizmit , Planifikimit dhe Mbrotje të Mjedisit që të rishqyrtojnë mundësinë e rritjes së etazhitetit të ndërtimit të objekteve nga P+4 në P+10, këtë kërkesë si lagje e kemi bazuar në planin e rei zhvillimor Komunal. Kërkesa bazohet në faktin se në disa pjesë të qytetit Drejtoria e Urbanizmit ka planifikuar objekte 10 katshe e në lagjen tonë ka caktuar P+4 qka mendojme se ky planifikim është I padrejtë. Kjo kërkesë mbështetet fuqishëm nga banoret e lagjes “ Ramadan Salihu” duke ju dëshmuar me listën e nënshkrimeve në vijim ”</i>	Parcelat kadastrale përgjatë rrugës “ Ramadan Salihu” në të dy anët , konkretisht në bllokun “ H “ sipas Planit Rregullues Urban “ Qendra-Zona I”, ku parametrat e ndërtimit aktualisht në brendi të bllokut janë me etazhitet P+4 kurse parcelat në hyrje të rrugës nga rruga ”Adem Jashari “ me etazhitet P+6 . Në Planin Zhvillimor Komunal destinimi do të jetë po i njeiti duke paraparë edhe Zonat për Shërbime kurse kushtet zhvillimore dhe parametrat e ndërtimit do të shqyrtohen, analizohen dhe përcaktohen në Harten Zonale të Komunës.

Nga takimi i mbajtur më datën 25.08.2020

Emri e Mbiemri	Data	Organizata	Ankesa	Arsyetimi
Shaban Terziu	25.08.2020	Shoqëria Civile	<i>Qytetarët po shqetësohen se ka ndërtime të larta, ngulfatje të mëdha ka shumë, qytetarët do ta bllokojnë rrugën nëse nuk ndërtohet nën kalimi tek shkolla “Thimi Mitko”.</i>	Segmentit rrugor “Livoq i Ulët-Gjilan” është projektuar dhe zbatuar nga Ministria Transportit dhe Infrastrukturës. Qështjen e sigurisë së lëvizjes së trafikut e këmbësorëve si dhe e ndikimit në mjedis, është arsyetuar në kuadër të projektit dhe nuk është e nevojshme të ketë nënkalim apo mbikalim te shkolla fillore “Thimi Mitko”.
			<i>Rruga Qarkore ekzistuese a do të ndryshoj apo do tmbetet e njejt</i>	Rruga Qarkore ekzistuese, është e harmonizuar gjendja me Plane rregulluese Urbane dhe si e tillë kryesisht do të mbetet e njejt .
			<i>Qendra a do të ndryshoj apo do tjetë e njejt</i>	Kryesisht do të ndryshohet me tipoplogji të banimeve të larta në mundësinë e krijimit e hapësirave të lira dhe shërbimeve sociale.
			<i>Shqetsimi mbi qështjen e ndërtimeve , a do të ketë vetëm ndertime të larta apo edhe të ulta</i>	Varësisht zonave do të jetë edhe tipologjia e banimeve në pjesën Urbane

Anëtarët e Ekipit Bazë:

1. Fadil Sherifi – i.d.a. : 
2. Sevdije Maliqi Hyseni – i.d.a. : _____
3. Habib Mahmuri – I.d.a. : 
4. Shaqir Ukshini – i.d.m : 
5. Ridvan Aliu – mr.sc.nd : 